

## Viti shkollor 2019 – 2020, miratohen çmimet dhe kategoritë që përfitojnë falas tekstet nga QBD




Miratohet vendimi për "Disa ndryshime në vendimin nr. 492, datë 10. 07. 2019 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019 - 2020". Sipas këtij vendimi, ndryshimet do të ketë në katër pika të tij. Përveç listës së teksteve shkollore për Diasporën për vitin shkollor 2019-2020, këtij vendimi do t'i bashkëngjitet lista e teksteve mësimore shtesë dhe lista e librave plotësues për mësimdhënien në Diasporë e miratuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën. Sigurimi i listave përkatëse dhe shpërndarja e teksteve shkollore shtesë dhe literaturave plotësuese të mësimdhënies do të financohet nga buxheti i Qendrës së Botimeve për Diasporën.

## Studentët shqiptar në Itali prezantojnë studimin për monumentet e kulturës



Studentët shqiptarë të arkitekturës në Itali prezantuan përfundimet e studimit të tyre të realizuar pak muaj më parë në disa nga monumentet kulturore shqiptare. Përfundimet e studimit u prezantuan gjatë një takimi të organizuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin i "IOM", ku mori pjesë edhe ministri i Shtetit për Diasporën. Në fjalën e tij ministri Majko vlerësoi kontributin e të rinjve për përfshirjen në projekte të tilla në dobi të vendit të origjinës së tyre, pasi si kurrë më parë Shqipëria ka nevojë për njerëzit e saj dijet dhe eksperiencën tyre. "Kjo nisim është një shembull i përsosur për ndërtimin e lidhjeve, shkëmbimin e informacionit dhe përvojave të Diasporës së kualifikuar shqiptare" u shpreh më tej ministri. Studuesit e rinj, pjesë e projektit "Diaspora si një burim për ruajtjen dhe përmirësimin e monumenteve kulturore më pak të njohura në Shqipëri"

## Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

## "Raporto" problemën në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

## Vizita në Belgjikë / Takimi me kryetarin e Bashkisë Namur dhe konferenca për Nënë Terezën



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko zhvilloi një vizitë pune në Belgjikë, ku u takua me kryetarin e Bashkisë së qytetit Namur, z. Maxime Prevot, me të cilin bashkëbisedoi për komunitetin shqiptar në Belgjikë, integrimin e tyre në shoqërinë belge dhe mundësinë e bashkëpunimeve në projekte të ndryshme, për ruajtjen dhe vazhdimësinë e kulturës shqiptare në këtë komunitet. Gjithashtu gjatë vizitës në Belgjikë ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë në konferencën "Nënë Tereza mes nesh" e organizuar në qytetin Namur, nga shoqata shqiptare "Nënë Tereza" në bashkëpunim me organizatën studentore "Vlera" dhe me mbështetjen e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Kosovës në Bruksel.



Mbledhja e radhës me anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e paketës ligjore që do të garantojë të drejtën e votës të gjithë shtetasve shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë.

## Festat e Nëntorit, Ansambli Kombëtar - koncert në SHBA

Diaspora shqiptare në New York feston 28-29 Nëntorin. Agjencia Kombëtare e Diasporës, nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, dhe në bashkëpunim me Ansamblin Popullor të Teatrit të Operas dhe Baletit, do të organizojnë koncert për festat e nëntorit. Koncerti do të zhvillohet më 1 dhjetor në New York, SHBA. Ansambli së bashku me artistët e njohur Merita Halili dhe Raif Hyseni do të prezantojnë muzikë dhe valle tradicionale shqiptare.



## QBD-ja miraton platformën e botimeve dygjuhëshe

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën miratoi platformën e botimeve dygjuhëshe të Qendrës së Botimeve për Diasporën, e cila do të fillojë me botimin e serisë së përrallave dygjuhëshe dhe të serisë së fjalorëve dygjuhësh. Kjo platformë synon t'u vijë në ndihmë fëmijëve të grupmoshave të ndryshme në Diasporë për të përvetësuar sa më mirë gjuhën shqipe. Në mbledhjen e radhës, mori pjesë Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, i cili nënvizoi nevojën urgjente të pajisjes me botime dygjuhëshe të fëmijëve në Diasporë dhe përparësinë që i duhet dhënë realizimit të tyre.

Mbledhja u drejtua nga Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën z. Piro Misha, drejtor i Bibliotekës Kombëtare. Të pranishëm ishin gjithashtu znj. Mira Hoxha, përfaqësuese e Ministrisë së Jashtme; znj. Anila Ferizaj, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit, si dhe znj. Mimoza Hysa, drejtore dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën, si dhe përfaqësues të Qendrës së Botimeve për Diasporën.



## FSHZHD-ja në kongresin e Unionit të Bizneseve

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës mori pjesë në zhvillimin e punimeve të Kongresit të II-të Ekonomik të "Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane", në datat 9 dhe 10 Nëntor, në Frankfurt të Gjermanisë. Në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës përfaqësues nga biznese të industrive të ndryshme, përfaqësues të fushave të ekonomisë dhe dhomave të bizneseve, përfaqësues politikë, institucione diplomatike dhe organizata joqeveritare ndërkombëtare nga Gjermania dhe trevat shqiptare. Diskutimet u përqendruan rreth mënyrave të bashkëpunimit midis bizneseve shqiptare në Diasporë dhe atyre në trevat shqiptare, si edhe bizneseve të huaja. U prezantuan biznese të ndryshme, u zhvilluan takime B2B si dhe u mbajtën diskutime për rritjen dhe konkretizimin e bashkëpunimit me strukturat shtetërore, veçanërisht ato në nivel lokal.



## KKD / Lazim Destani merr pjesë në Kongresin e Unionit të Bizneseve Shqiptaro- Gjermane

Anëtar i Këshillit Koordinues i Diasporës dhe kryetar nderi i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës, z. Lazim Destani, ishte pjesëmarrës në Kongresin e II-të Ekonomik të "Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane" që u zhvillua këtë fundjavë në Frankfurt të Gjermanisë. Gjatë fjalës së tij, Destani vlerësoi gjendjen ekonomike në trojet shqiptare, si një sfidë të radhës, të cilës i nevojitet mbështetja dhe potenciali i bizneseve të Diasporës, në krijimin e një klime pozitive. Kjo klimë mendohet të sjellë zhvillimin ekonomik në vendin e origjinës. Në këtë kongres morën pjesë edhe përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës, përfaqësues të tjerë nga fusha e ekonomisë, politikës, bizneseve si dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare nga Gjermania dhe trevat shqiptare.



Shkrimtari i njohur shqiptar Gazmend Kapllani, i vlerësuar në arenën ndërkombëtare, përfaqësues i komunitetit shqiptar në Greqi dhe anëtar i Këshillit Koordinues i Diasporës, vlerësohet nga kritika franceze. Ai është finalist i çmimit letrar "Prix Méditerranée étranger 2020" për romanin e përkthyer në frëngjisht "I Keqi i Vetes". Lajmin e përcjeli vetë autori. "Prix Méditerranée" është një çmim letrar francez i themeluar në vitin 1984 dhe i jepet çdo vit një libri me prozë në gjuhën frënge (roman, ese, kujtime ose tregime të shkurtra) me një temë mbi Mesdheun. "Prix Méditerranée étranger" themeluar më 1992, i jepet një autori mesdhetar jo francez, vepra e të cilit është përkthyer në frëngjisht.



## KKD/ Gazmend Kapllani vlerësohet nga kritika franceze